



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT
DREJTORIA E CILËSISË DHE INSPEKTIMIT TË USHQIMEVE

Nr. 1824 Prot.

Tiranë, më 10.05 2005

U R D H Ë R

Nr. 214 Datë 10.05 2005


MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PRAKTIKAT E MIRA TË
MENAXHIMIT PËR MAGAZINAT E RUAJTJES DHE
SHPËRNDARJES SË QUMËSHTIT DHE PRODUKTEVE TË TIJ”**


Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 5. 6 të Ligjit Nr.7941 datë 31.05.1995 “Për Ushqimin” me propozim të Drejtorisë së Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve.

U R D H Ë R O J

1. Miratimin e rregullore “Për praktikat e mira të menaxhimit për magazinat ruajtjes dhe shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij” bashkëlidhur këtij Urdhëri.
 2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



MINISTRI


Agron DUKA

RREGULLORE
“PER PRAKTIKAT E MIRA TE MENAXHIMIT PER MAGAZINAT
E RUAJTJES DHE SHPERNDARJES SE QUMESHTIT DHE
PRODUKTEVE TE TIJ”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 5, 6 të Ligjit Nr.7941 datë 31.05.1995 “Për Ushqimin” me propozim të Drejtorisë së Cilësisë dhe Inspektimit të Ushqimeve, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit nxjerr këto rregullore:

Praktika e mirë e menaxhimit për magazinat e ruajtjes dhe shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij është një mjet praktik që mundëson arritjen e një prej qëllimeve të tij i cili është të planifikojë, nis dhe vëzhgojë zbatimin e metodave të aprovuara në ruajtjen e qumështit.

Perkufizim termi:

"magazine e ruajtjes dhe shpërndarjes së qumështit" do të thotë një magazine qumështi e përdorur kryesisht për ruajtjen e qumështit të pakëtuar për dorezim tek tregëtari i nën –produkteve të qumështit (përkatesisht automjetit të kompanisë respektive), por përjashton ndertesen në të cilën qumështi shitet me pakicë, ose ndonjë ndertese ose vend në të cilin qumështi përpunohet apo pakëtohet.

I. Kërkesat për ambientet e jashtme për magazinat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij dhe magazinat dhe paisjet e ruajtjes së qumështit.

1. NE PERGJITHESI

- (a) Magazinat e ruajtjes dhe shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij dhe zona përreth duhet të mbahen pastër dhe në kushte të rregullta.
- (b) Asnjë pjesë e magazinave të ruajtjes dhe shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij nuk duhet të përdoret si zone zhveshje apo fjetjeje e stafit.

2. ZONAT E KALIMIT TE MAKINAVE DHE ZONAT E PARKINGUT

- (a) Rrugët e makinave dhe zonat e parkingut për shpërndarjen e qumështit duhet të jenë të shtrëna me beton, asfalt, ose material të ngjashëm të aprovuar dhe të mbajtur në kushte të pastra.
- (b) Sipërfaqet për zonën e pastrimit të automjeteve duhet të jenë prej betoni ose materialeve të tjera të qëndrueshme dhe rezistente ndaj gërryerjes, dhe duhet të kenë një drenazh me kënd prej 1:50 në një kanal të lidhur me sistemin e kullimit të ndërmarrjes.
- (c) Magazinat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij duhet të pajisen me një burim uji të përshtatshëm për operacionet sanitare dhe ato të pastrimit.

3. VENDET E NGARKIM – SHKARKIMIT

- (a) Dyshemetë dhe kanalet e lidhura me to, ku qumështi, produktet e qumështit, detergjentët dhe mbetjet rrjedhin, duhet të ndertohen dhe të aprovohen me material rezistent ndaj gërryerjes.
- (b) Gjate marrjes në dorëzim dhe shpërndarjes, qumështi dhe produktet e qumështit duhet të mbrohen nga kontaminimi, nga catia.

4. KULLIMI NE SIPERFAQE

Në magazinat e ruajtjes dhe të shpërndarjes së qumështit dhe produkteve të tij duhet të ekzistojë një sistem i kullimit në sipërfaqe që do të lejojë levizjen e shpejtë dhe efikente të ujit të tepërt nga catia, ndërsa, rrugët e kalimit të makinave, dhe zonat e hapura në një pike ku mund të shkarkohet lehtë. Këto kanale kullimi duhet:

- (a) të ndertohen me pendence të rregullt dhe të jenë në çdo vend ku ekziston mundësia që uji të mbledhet;
- (b) kur kryqësohen me vende të kalimit publik, të ndertohen me kujdes në mënyrë që të mos krijojnë rrezik për kalimtarët.

5. KULLIMI (Drenazhim)

- (a) Kanalet e kullimit në të cilat do të derdhet uji që përmban materiale solide (mbetje të produkteve të qumështit) të ndertohen me materiale të përshtatshme dhe të mbahen pastër, të plotesojnë kushtet sanitare dhe të menjanojnë aromat e pakëndshme.
- (b) Kullimi në dalje nga depot e shpërndarjes së qumështit duhet të kalojë në përputhje me kërkesat e autoritetit të përcaktuar që kontrollon derdhjen e mbetjeve.

II. NDERTESA

I. E PERGJITHSHME

- (a) Ndertesa e re te ndertohet ne menyre te tille qe te lejoje akses per mirembajtjen dhe pastrimin.
- (b) Te gjitha ndertesat duhet te ndertohen dhe mirembahen ne menyre qe te minimizojne hyrjen dhe shperndarjen e pluhurit, insekteve dhe brejtesave.
- (c) Pjesa e brendshme e ndertesës duhet te mbahet e lire nga pluhuri, insektet dhe brejtesat.

2. CATITE

- (a) Te gjitha catite duhet te jene:
 - (i) Te mbrojtura perkunder kushteve te motit;
 - (ii) Te ndertohet me materiale qe lehtesojne pastrimin;
 - (iii) Te mirembajtura ne kushte te pastra
- (b) Catite duhet te kene kanale te dizenuara ne menyre te pershtatshme, te vendosen dhe te mirembahen tuba te poshtem me mase te pershtatshme ne menyre qe te heqin ujrát e teperta te shiut dhe t'i kalojne ato ne sistemin e kullimit, te cilat te jene me nivele te kontrolluara mire, per te parandaluar mbingopjen.

3 DHOMAT E FTOHJES

(a) Veshja e tubave per ftohje

Dyshemeja, muret, tavani, dhe dyert te vishen ne menyre te tille qe ta mbajne dhomen ne temperaturën e percaktuar dhe jo me shume se 4°C.

(b) Dyshemete

Dyshemeja te ndertohet me materiale te pershtatshme, rezistente ndaj gerryerjes, jo-toksike dhe te lehta per t'u pastruar. Te kene sipërfaqe qe te minimizojne rrezikun e rreshkitjes, te mbajtura ne menyre te pershtatshme dhe me pjerresi te mjaftueshme qe lejon kullimin te perfundoje ne dalje te mbrojtura nga pengesa.

(c) Muret

Muret te ndertohen ne konstruksione betoni te pakten 150 mm te larta ne pershtatje me specifikimet e perfshira ne kete rregullore dhe te mbulojne dyshemene me nje rreze minimale prej 25 mm.

Muret e brendshme te lyhen me nje ngjyre te lehte dhe me drite, me materiale te papershkueshme nga uji, jo-toksike dhe te lehta per t'u pastruar, te jene rezistente ndaj efekteve te ndryshme dhe te mbrojtura nga keto efekte. Pjeset e paisjeve te cilat jane te

lidhura dhe te fiksuara ne mure, te jene te vulosura ne menyre efektive qe ti qendrojne solucioneve te nxehta per sanitizimin dhe larjen.

(d) Tavanet

Tavanet te disenjohen dhe te ndertohen ne menyre qe te parandalojne akumulimin e papastertive, minimizimin e kondensimit dhe te jene te lehta per t'u pastruar, te ndertohen me material te aprovuar, te papershkueshem nga uji, jo-toksik dhe me ngjyre te ndritshme i cili te jete i afte t'i mbijetoje, rezistojte solucioneve te nxehta per pastrimin dhe sanitizimin.

(e) Dyert dhe dorezat e dyerve

Dyert dhe dorezat e dyerve te ndertohen me materiale te rezistueshme ndaj ndryshkut dhe te kene siperfaqe te lemuara te papershkueshme nga uji. Te gjitha dyert e hyrjes te paisen me mjete qe menjanojne humbjen e ajrit te ftohur nga mjetet frigoriferike kur jane ne perdorim.

(f) Ndricimi

Intensiteti i drites se percaktuar te jete ne perputhje me Standartet e ndricimit te brendshem.

(g) Paisjet ftohese

Dhomat ftohese te paisen me paisje ftohese te afia per mbajtjen e temperatures se qumeshtit ne jo me shume se 4°C qe konsiderohet si maksimumi i kerkeses per ftohje. Ne njesite e detyruara per ftohjen e ujit te kullimit te ekzistojne tabaka per rrjedhjen, te cilat te jene te lidhura ne menyre direkte me sistemin e kullimit.

(h) Raftet dhe Gabinat

Kur shikohet e nevojshme, dhomat e ftohjes te paisen me dollape ose rafte te cilat i rezistojne ndryshkjes dhe 'gabina' per makinat e kompanive qe sjellin produktin.

(i) Regjistrimi i temperatures

Nje paisje per regjistrimin e temperatures te vendoset ne cdo dhome ftohjeje dhe te pozicionohet ne ate menyre qe te jete lehtesisht e lexueshme nga jashte, te paisen me nje sistem paralajmerues per te treguar nese temperatura e dhomes kalon 4°C.

4. ZONAT E PRANIMIT

Zonat e pranimit te qumeshtit dhe produkteve te tij te lidhura me dhomat e ftohjes te paisen me nje sistem paralajmerues dhe mekanizem "kycje" ne menyre qe te minimizoje humbjen e ajrit te ftohte.

5. VENDET E NGARKIMIT TE SUBJEKTEVE QE MARRIN PRODUKTIN

- (a) Zonat e ngarkimit te paisen me cati dhe te kene nje zone te shtruar me pllaka dhe me pjerrresi ne menyre qe te kullojne ne sistemin e kullimit te ndermarrjes.
- (b) Nivelet e platformes te jene ne lartesi qe lejon lehtesisht marrjen e mallit gjate ngarkimit te tij.
- (c) Muret e dhomave te jashtme te ftohjes dhe dyert e jashtme te ngarkimit duhet te jene jo me shume se 600mm nga cepi i platformes se ngarkimit.

6. RUAJTJA E QUMESHTIT DHE PRODUKTEVE TE TIJ

- (a) Dhomat e ftohjes te kene hapesire te mjaftueshme per te vendosur sasine e qumeshtit dhe produktet e tij ne menyre te tille qe te mbahet brenda nderteses ne cdo kohe dhe te kete qarkullim te mjaftueshem ajri.
- (b) I gjithe qumeshti te ruhet ne nje dhome te ftohte ne temperature qe nuk i kalon 4°C.
- (c) Qumeshti dhe produktet e tij te ruhen ne menyre te tille qe qarkullimi i stoqeve te jete lehtesisht i mundur.
- (d) Te ekzistojte hapesire e mjaftueshme ne menyre qe te kete levizje normale ne cdo kohe per ne dhomat e ftohjes.
- (e) Dhomat e ftohjes te mbahen ne kushte te pastra ne cdo kohe.

7. UJI

- (a) Te kete furnizim te mjaftueshem me uje te ngrohte jo me pak se 75°C dhe uje te ftohte te pijshem.
- (b) Paisjet e ujit te pijshem te perimbushin standartet e Organizates Boterore te Shendetit per Ujin e Pijshem dhe kerkesat e legjislacionit shqiptar.

8. VENDET E INSTALIMIT TE TUBAVE PREJ GOME

- (a) Instalimi i tubave prej gome te behet ne ndertese ne vende te posaqme lehtesisht te arritshme.
- (b) Tubat prej gome kane ne cdo vend instalimi kuti ku ato te mblidhen. gjate kohes qe nuk perdoren. e cila eshte me material qe i reziston ndryshkut.

9. VENDET E LARJES SE DUARVE NE ZONAT E PUNES Vende te mjaftueshme per larjen e duarve te ekzistojne per te lejuar zbatimin e praktikave te pershtatshme sanitare.

10. SHENJAT KUNDER PIRJES SE DUHANIT

Shenjat kunder pirjes se duhanit vendosen ne vende te dukshme gjate gjithë hapësirës së magazinave të ruajtjes dhe të shpendarjes së qumeshtit dhe produkteve të tij.

11. HEDHJA E MBETURINAVE

Jashtë magazinave të ruajtjes dhe të shpendarjes së qumeshtit dhe produkteve të tij ndertohen qendra të mbledhjes së mbeturinave dhe mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Te gjitha koshat e hedhjes së mbeturinave paisen me kapake të pershtatshëm për mbylljen e tyre.

12. BANJAT

(a) Tualete me gropa septike apo kanale vendosen perkunder ose brenda ndertesave të magazinave të ruajtjes dhe të shpendarjes së qumeshtit dhe produkteve të tij; dhe ndertohen me dysheme betoni. Tualeti duhet:

(i) Te jete izoluar me kyc dhe me ajrim i ndare nga ndertesa. me hyrje vetem nga jashte: dhe/ose

(ii) te jete me ajrim i ndare nga ndertesa me mundesine per hyrje te brendshme me ane te nje dere qe mbyllet me perde ajri.

(b) Tualete kimike dhe pa kanale ndertohen me materiale te posaçme dhe kane dysheme betoni. Vete-tualeti duhet te jete i mbrojtur nga mizat. Keto lloj tualetesh vendosen te pakten 20m nga ndertesat e depove te shpendarjes se qumeshtit.

(c) Vendet ku lahen duart me sasi te mjaftueshme uji dhe sapuni dhe paisje te tharjes se shpejte te duarve ne afersi me tualetet. vendosen ne çdo magazine të shpendarjes së qumeshtit.

13 VENDET E VESHJES SE STAFIT

Aty ku dhomat e veshjes se stafit jane perfshire ne ndertesat e magazinave te ruajtjes dhe te shpendarjes se qumeshtit dhe produkteve te tij. duhet te:

(a) jene te ndertuara me material te posaçem

(b) (i) te jene te kycura dhe te ndara nga ndertesa me hyrje vetem nga jashte: dhe/ose

(ii) te jene te ndara nga ndertesa me hyrje nga brenda me ane te nje dere qe mbyllet/hapet me perde me ajer;

(c) vendet ku vendosen celesat per punonjesit. te ndertohen me metal dhe te ngrihen jo me pak se 40cm mbi dysheme me ate te nje metode te aprovuar dhe te vendosura ne kend jo me pak se 45 grade.